



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prima: Detyrat Punësi: Prodato Redukto: Detyrat	22.04	2022	2	viti god year
Organ Agjencia Organ / Jedinita Org / Unit	Pr. Prok Pr. Prok Pr. Prok	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIDINSHICK	2356/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 222/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.222/2022, të datës 11.03.2022, të parashtruara nga ankuesja kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës-nivelizim i koeficientit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.222/2022 e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësës civile nga koeficienti pesë pikë pesë (5.5) në koeficientin gjashtë pikë pesë (6.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja nëpunëse civile në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës më datë 11.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1290/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti behët harmonizimi i koeficientit të pagës me koleget e saj duke shtuar së është diskriminuar në pagë nga ana e punëdhënësit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1290/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjeni në ankesë me numër të protokollit 221 të datës 16.06.2021; Akt-in e emërimit të datës 05.07.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për Shërbime të Punësimit"; Kërkesën e datës 22.11.2017; Kërkesën me numër 148/2021 të datës 18.05.2021; Emalin e datës 19.05.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 28.01.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.03.2021 deri me 31.03.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.04.2021-30.04.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.05.2021-31.05.2021; Aktin e emërimit me numër APKK 21 të datës 28.12.2017; Certifikatën me numër Ref.nr.D-0496/13 të datës 22.07.2013; Listën e Pagave për periudhën kohore 31.03.2021-31.03.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.04.2021-30.04.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.05.2021-31.05.2021; Akt-in e emërimit me numër APRK 149 të datës 28.12.2017; Certifikatën me numër Nr.07/8/271-283/82 të datës 01.10.1991; Akt-in e emërimit me numër APRK 14 të datës 28.12.2017; Diplomën me numër 4671 të datës 12.07.1984; Akt-in e emërimit me numër APRK 18 të datës 28.12.2017; Diplomën me numër 267 të datës 12.12.1990; Akt-in e Emërimit të datës APRK 70 të datës 28.12.2018; Diplomën me numër 1706 të datës 15.12.2010; Akt-in e emërimit APRK 142 të datës 28.12.2017; Akt-in e emërimit me numër 48 të datës 20.05.2013; Diplomën me numër Nr.2353 të datës 29.09.2012; Vendimin me numër të protokollit 2343/2021 të datës 11.05.2021, diplomën me numër 7481/15, të datës 26.06.2015 të ankuese për përfundimin e studimeve universitare.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuses është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokollit APRK 33 të datës 28.12.2017, është e punësuar në Agjencinë e Punësimit në pozitën e punës *Zyrtare për Shërbime të Punësimit-Zyra e Punësimit* në Lipjan, me koeficient pesë pikë (5.5) të pagës. Me tej, Kolegji verën se ankuesja disa herë i është drejtuar me kërkesë organit të punësimit për nivelizimin e koeficientit të pagës nga 5.5 në 6.5 sikurse koleget e saj në të njëjtën pozitë, por që një kërkesë e tillë nuk është aprovuar, konkretisht ankuesja me datë 18.05.2021 i është drejtuar me kërkesë të njëjtë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit, i cili më datë 19.05.2021, në shkresën e kërkesës se ankuses të datës 18.05.2021 shënon *refuzohet si e pa bazuar*. Ankuesja me datë 25.05.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendime të njëjta për harmonizim të koeficientit të pagës nga 5.5 në 6.5. Këshilli në mungesë të anëtarëve nuk ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e ankuses të datës 25.05.2021, duke udhëzuar për veprime tjera ligjore.

Ankuesja serish me datë 11.03.2022 parashtron ankesë me bazë dhe qëllim të njëjtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se është diskriminuar në të drejtën e saj në pagë pasi që koleget e saj me pozitë dhe punë të njëjtë realizojnë koeficient 6.5 të pagës.



Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën përkatëse, duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë. Andaj, në vështirim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar së brenda institucionit të njëjtë punëdhënës aplikohen koeficient të ndryshëm të pagës për nëpunës civilë me pozitë të Zyrtarit për Shërbime të Punësimit, përkatësisht nga provat materiale është konstatuar se sipas Akt emërimit APRK Nr.149 të datës 28.12.2017 nëpunësi civil në pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit në Zyrën e Punësimit në Vushtrri ka koeficient 6.5 të pagë, sipas Akt emërimit APRK Nr.14 të datës 28.12.2017 nëpunësja civile në pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit në Zyra e Punësimit në Prishtinë ka koeficient 6.5 të pagës, sipas Akt Emërimit APRK nr.18 të datës 28.12.2017 nëpunësja civile në pozitën e punës Zyrtare për Shërbime të Punësimit-Zyra e Punësimit në Fushë Kosovë, ka koeficient 6.5 të pagës, sipas Akt emërimit me numër APRK nr.70 të datës 28.12.2018 nëpunësi civil në pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit në Zyrën e Punësimit në Klinë ka koeficient gjashtë pikë pesë (6.5) të pagës, kështu që bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozitë të njëjtë dhe më detyra të njëjta të punës, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të nëpunësve civil brenda të njëjtit institucion dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 të të njëjtit ligj ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, kështu që mbi këto arsye Kolegji konstaton së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses.*

Po ashtu Kolegji nga analizimi i përshkrimit të detyrave të punës për pozitën e punës Zyrtar për Shërbime të Punësimit ka konstatuar se ankuesja plotëson të gjitha kërkesat dhe kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë, respektivisht sipas përshkrimit të detyrave të punës lidhur me pozitën në fjalë kërkesa themelore janë përcaktuar: diplomë universitare nga fusha e shkencave ekonomike, juridike dhe sociale si dhe së paku dy vite përvojë pune, ndërsa ankuesja sipas diplomës me numër 7481/15, me datë 26.06.2015 ka përfunduar studimet themelore universitare në Menaxhment dhe Informatikë/ Fakulteti ekonomik, dhe e njëjta është e punësuar në këtë pozitë që nga janari i vitit 2000.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si më lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Agjencia e Punësimit me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankueses ka vepruar kundërshtim edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe*

paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.222/2022

Ilire Mehmeti -Shaqiri


Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Punësimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

